

SHENIME SPJEGUESE

Shoqeria "EUROPA" sh.p.k, me ortake, Z. Vangjel Rula dhe Thanas Rula , zhvillon veprimtarine ekonomike ne njesine administrative Bradashesh, (ish Kombinati Metralurgjik) ne Elbasan.

A I Informacion i pergjithshem,

1.Per plotesimin e Pasqyrave Financiare te vitit 2019, jane zbatuar politikat kontabel te percaktuara ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara, ne zbatim te Ligjit 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.Ndertimi i Pasqyrave Financiare dhe paraqitja e elementeve te veçante eshte siç parashikohet ne SKKP 2, i permiresuar, duke bere ndryshimet perkatese.

3.Baza e pergatitjes se Pasqyrave Financiare: Te drejtat e detyrimet e konstatuara (SKKP 1)

4. Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e PF: (SKKP 1)

a. Njesia ekonomike raportuese, ka mbajtur ne llogarite e saj, aktivet, pasivet dhe tranksaksionet ekonomike te veta,

b. Vijimesia, e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuese eshte e siguruar, duke mos pasur ne plan ose nevojë, nderprerjen e aktivitetit te saj.

c. Kompesim, midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka, ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve, ka vetem ne rastet kur lejohen SKKP.

d. Kuptushmeria, e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote, per te qene te qarta dhe te kuptueshme, per perdorues te jashtem , qe kane njohuri te pergjithshme e te mjafteshme, ne fushen e kontabilitetit.

e. Materialiteti, eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij, Pasqyrat Financiare, jane hartuar vetem per zera materiale.

f. Besueshmeria, per hartimin e Pasqyrave Financiare, eshte e siguruar pasi nuk ka gabime, materiale duke zbatuar parimet e meposhteme:

- Parimin e paraqitjes me besnikeri
- Parimin e perparemise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
- Parimin e paaneshmerise pa asnje influence te qellimshem
- Parimin e maturise, pa optimizem te tepruar, pa nen e mbivleresim te qellimshem
- Parimin e plotesise, duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF
- Parimin e qendrushmerise, per te mos ndyshuar, politikat e metodat kontabel

- Parimin e krahasueshmerise, duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat Kontabel

Per percaktimin e kostos se inventareve, eshte zgjedhur metoda „FIOFO“ (Hyrja e pare dalje e pare, SKK4)

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM, qe ploteson kriteret per njohjen si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto (SKK 5, 11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM, kur kjo financohet nga nje hua, kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivitetit, per periudhen e investimit. (SKK 5)

Per vleresimin e mepasshem te AAM, eshte zgjedhur modeli i kostos, duke paraqitur ne bilanc, me kosto, minus amortizimin e akumuluar (SKK 5)

Per llogarritjen e amortizimit te AAM (SKK 5), njesia jone ekonomike ka percaktuar, si metode te amortizimit te ndertesave dhe AA Materiale te tjera, metoden e amortizimit mbi bazen e vleres se mbetur. Normat e amortizimit, jane perdorur te njejta, me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht:

- a. Per ndertesat me 5 % te vleres se mbetur.
- b. Per kompjutera e sisteme informacioni me 25 % te vleres se mbetur.
- c. Te gjitha aktivet e tjera materiale, me 20 % te vleres se mbetur.

B. Shenimet qe spjegojne zerat e ndryshem te Pasqyrave Financiare.

Aktivet monetare jane 72.271.055 leke, prej te cilave ne banke jane 72.220.638 leke, dhe mjete monetare ne arke jane ne shumen 50.417 leke.

Te drejta te arketueshme ne shumen 285.611.871 leke gjithsej; nga aktiviteti i shfrytezimit, llogaria 411 Kliente, jane 263.515.459 leke dhe ne ne zeri te tjera, shuma 46,792,907 leke, perbehet nga teprica kreditore e TVSH-se per shumen 20.180.672 leke dhe 1.915.740 leke jane pagesa tatim fitimi me teper.

Tek zeri i inventarit, materiale te para dhe ndihmese , gjendje me 31.12.2019, te vleresuara me koston e magazinimit jane 50.965.888 leke dhe prodhime ne proces dhe gjysem produkte jane 22.497.896 leke. Gjithashtu ne zerin Parapagime per inventar eshte shuma 5.244.459 leke.

Ne aktivet afatgjata materiale shuma 182.039.687 leke shpreh vleren kontabel te te gjitha aktiveve ne date 31.12.2019. Vlerat historike, shtesat dhe amortizimi jane deklaruar ne pasqyrat shtese, te cilat i jane bashkengjitur pasqyrave financiare. Theksojme se ne pasqyrat e ketij viti eshte bere nje ndryshim duke shtuar vleren fillestare te mjeteve te transportit me 16.456.920 leke (autovinç 100 Ton) dhe eshte pakesuar, zeri makineri, paisje e instalime po per te njejten vlere. Ndryshimet jane bere edhe ne vleren e amortizimit te mbartur dhe vleren kontabel, per ted y zerat.

Gjithashtu ne aktivet material, ne zerin parapagime per active material jane 19.665.855 leke.

B: Detyrimet dhe Kapitali.

Ne detyrimet afatshkurtra, shuma 156.876.948 leke, shpreh shumen e detyrimeve te subjektit:

a. per arketime ne avance per porosi ne shumen 55.219.921 leke, b. detyrimi ndaj furnitoreve per 97.922.618 leke, c. detyrimeve ndaj punonjesve e sigurimeve shoqerore e shendetesore, shuma 2.275.145.

Ne detyrimet tatimore, shuma 1.459.264 leke eshte per tatimin mbi page.

Ne pjesen e kapitalit dhe rezervat, jane bere ndryshimet e meposhteme:

Me vendim te Ortakeve, ne kete vit eshte jane bere ndryshimet e meposhteme:

a. Jane shperndare nga kapitali i shoqerise 50.000.000 leke

b. Nga fitimi i vitit 2018, jane shperndar 50.000.000 leke dibident

c. Eshte rritur kapitali per 20.000.000 leke dhe rezervat ligjore per 1.378.041 leke

Llogarritja e fitimit te realizuar per vitin 2019, eshte si me poshte:

Nr	Emertimi	Njesia	Shuma
1	Te ardhurat	leke	726858344
2	Shpenzimet	leke	656.781935
3	Fitimi bruto i ushtrimit	leke	70.076.409
4	Shpenzime te panjohura	leke	7.650
5	Norma e Tatim Fitimit	%	15 %
6	Tatim Fitimi	leke	10.512.610
7	Fitimi neto	leke	59.563.800

1.PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE:

Formati i Pasqyres Te Ardhurave dhe Shpenzimeve, pasqyron klasifikim e shpenzimeve sipas natyres se tyre homogjene.

Te ardhura nga aktiviteti kryesor i shfrytezimit jane 661.998.798 leke, qe perfaqeson shumen e te ardhurave te realizuara nga shitja e produktit te gatshem. Gjithashtu ne vitin 2019 kemi shtim tte produktit te gatshem dhe ne proces, me 15.118.585 leke. Te ardhura te tjera te shfrytezimit, ne shumen 9.660.546 leke perbehet nga shitja e nenprodukteve (Skrap) jane 6.644.353 leke dhe sherbimeve per vitin ushtrimor 2019 jane 3.016.193 leke. Te ardhurat jane shtuar edhe me 38.562.500 leke, mga prodhimi i aktiveve materiale nga vete shoqeria.

Materiale te perdorura ne procesin e prodhimit jane 441.892.297 leke, vleresuar me koston e magazinimit.

Shpenzime te personelit jane 104.247.313 leke, e ndare, per pagat 90.595.815 leke dhe 13.651.498 leke jane, shpenzime per sigurimet shoqerore e shendetesore.

Shpenzime amortizimi gjithsej per 24.942.052 leke, perfshin amortizimin e aktiveve afatgjata materiale Detajimi eshte si ne pasqyren bashkengjitur.

Shpenzimeve te tjera te shfrytezimit te kryera gjate vitit 2019 jane 82.900.949 leke te detajuara si llogarive perkatese ne pasqyren e shpenzimeve te tjera te shfrytezimit..

Te ardhura te tjera, shuma 222 leke, shpreh vleren e interesave te fituara nga veprimet ne banke dhe 1.517.693 leke te ardhura nga kembimet valutore dhe 2.799.324 leke jane humbje nga kembimet valutore..

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare: eshte pergatitur sipas Metodes Direkte dhe ne te, pasqyrohen hyrjet e daljet e mjeteve monetare gjate periudhes raportuese. Mbi bazen e kesaj pasqyre jepet informacion, per mjetet monetare te siguruara e te perdorura, burimet e financimit dhe ndryshimi qe ndodh ne pozicionin e mjeteve monetare.

Keshtu mjete monetare te arketuara gjate vitit ushtrimor jane 736.532.315 leke, ndersa pagesat e kryera per furnitoret dhe punonjesit jane 653.621.908 leke.

Me poshte nepermjet pasqyres po japim te detajuar pagesat e kryera:

Nr	Emertimi	Shuma
1	Furnitoret	518,423,057
2	Pagat e punonjesve	74,730,262
3	Sig. Shoq % shendet.	22,210,594
4	TAP	6,187,483
5	Udhetim e dieta	31,086,261
6	Sponsorizime	270,000
7	Gjoha e penalitete	7,650
8	Komisione	706,601
	SHUMA	653,621,908

Shuma e mjetve monetare ne fund te periudhes raportues eshte eshte 72.271.055 leke

Pasqyra e ndryshimit te kapitalit, eshte pergatitur sipas SKK.3 Ne kete pasqyre jane te saktesuara sipas zerave ndyshimet e kryra per vitin 2019, ne zbatim te Vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Hartuesi i Bilancit

Shkelqim Sako



Administratori

Thanas RULA

